



VENDIM

Nr. 110 Datë 18.11.2014

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.79, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes të energjisë elektrike”, ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës **18.11.2014**, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a për përcaktimin e tarifave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 si dhe relacionin e grupit të punës,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për aktivitetin e shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 110 Datë 18.11.2014

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS
PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
VITIN 2015**

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundra |
|---------------|-------|--------|
| Petrit Ahmeti | _____ | _____ |
| Adriatik Bego | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Maksim Shuli | _____ | _____ |